



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:022578  
Datë: 27.05.2024  
Numri i dokumentit: 05740087

**C-IV.-14-0084**

*Ankuesja:*

I S nga Arengjelovaci. R.e Serbisë, të cilën e përfaqëson M Sh, avokat nga Prishtina.

*Kundër*

*E paditura:*

**NSH. "EXIMKOS" (ne likuidim), e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit  
AKP-së-Zyra Rajonale në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", Nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Dr.sc. Murat Hulaj, me 24. majë 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN092-0113 datës 09.10.2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Ankuesja e ka paguar taksën gjyqësore dhe nuk ngarkohet me taksë shtesë.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 06 janar 2014, ankuesja përmes përfaqësuesit të autorizuar av. M Sh av. nga Prishtina, dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. **PRN092-0113 të datës 09.10.2013**, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar qe te rishikohet aktvendimi i AL, i njëjti te ndryshohet dhe te aprovohet kërkesa për rishikim si e bazuar dhe parashtresës se kërkesës t'ia njoh te drejtën e pagesës se të ardhurave personale te perealizuara nga Qershori i vitit 1999 e deri ne shtator te vitit 2007 në lartësi prej 20.00,00 euro si burgje kryesor me kamat ne lartësi prej 3,5% duke filluar nga qershori i vitit 1999 e deri ne pagesën përfundimtare, apo te njëjtin vendim ta PRISH dhe çështjen ta kthej ne rivendosje, duke shtuar se vendimi për të cilin paraqitet kërkesa për rishqyrtim është i gabuar nga se , Autoriteti i Likuidimit NSH "EXIMKOS" ( ne Likuidim ) nuk

ka vendosur lidhur me kërkesën që del nga obligimi i NSH “EXIMKOS” për pagimin e të ardhurave personale si kërkesa shumë të ligjshme . Prandaj, pavarësisht shkeljeve tjera ky vendim i kundërshtuar me ankesa nuk mund të qëndroj, kështu që, ai ose duhet të ndryshohet duke e aprovuar ankesën nga ana e Dhomës së Posaçme. Me teje në ankesë potencohet se vendimi i AL është i përfshirë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike ngase gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale duke u shkelur ligji në dëme të parashtrueses së kërkesës I S. Në mbështetje ankimore ndaj vendimit të AL, si provë ka bashkangjitur dokumentin me të cilin vërtetohet fakti se parashtruesja e kërkesës ka qenë punëtore e NSH. “EXIMKOS” me seli Prishtinë, krahas duke premtuar se në të ardhmen nëpërmes të autorizuarit të saj, gjykatës do i sjellë ekspertizë gjyqësore nga lëmi ekonomik, dhe se fundmi duke ri konfirmuar propozimin që për shkak të këtyre shkeljeve ligjore , vërtetimit të gabuar dhe të mangët të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale , vendimi i kundërshtuar duhet detyrimisht të ndryshohet dhe të aprovohet kërkesa për kompensimin të demit apo të prishet dhe çështja e kësaj kërkesë të kthehet në rivendosje.

Me 11 shkurt 2016, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtje, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankueses është e pabazuar dhe e pa mbështetur në prova, meqë sipas nenit 7 të LPK-së , parashtruesi ka barrën e provave, në procedurë para gjykatës. Po ashtu sipas AKP-së konform nenit 208 të Ligjit të Punës së Bashkuar kërkesa e ankueses për paga është parashkruara, duke shtuar se një kërkesë monetare e çfarëdo lloji që një punëtor mund të ketë ndaj një punëdhënësi duhet të jetë paraqitur para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare nga momenti kur N.SH-ja supozohet të mos i ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj parashtruesit. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Me 13 shkurt 2016, Gjykata përmes postes e ka dorëzuar mbrojtjen e AKP-së tek ankuesja, për parashtruar ndonjë përgjigje në mbrojtjen e AKP-së, nr.6394 të dt. 11.02.2016, e cila edhe ka rezultoi me dt. 25.marsë 2016 (fq. 26, 27)nga ankuesja përmes të autorizuarit të saj duke ri konfirmuar se pretendimet e theksuar të mbrojtjes -AKP-së, nuk qëndrojnë, nuk kanë bazë ligjore dhe as që kanë as mbështetje ligjore dhe as faktike.

Ankuesja në tersi pranë pretendimeve të theksuara në kërkesën për Rishqyrtim të vendimit të ankimuar -Aktvendimit të Autoritetit të likuidimit të NSH “EXIMKOS” në likuidim ) në kuadër të AKP-së-Zyrës Rajonale në Prishtinë 10441 të datës 09.10.2013, me nr. të kërkesës PRN092-0013 me propozim që të aprovohet kërkesa për rishqyrtim të vendimit të ankimuar ngase pretendimet e mbrojtjes nuk kanë kurrfarë mbështetje juridike.

E paditura AKP, me dt. 07.prill 2016, si palë kundërshtare është kundërpërgjigjur ndaj mbrojtjes së paditëses e cila kishte dhënë përgjigje me dt. 13 shkurt 2016.

Kundërpërgjigjeje e të paditurës AKP-së si palë kundërshtare synohet në pikat vijuese:

- Duke kundërshtuar edhe njëher si ekzistencën ashtu edhe lartësinë e detyrimit të pretenduar dhe thekson rregullin bazik të procedurës civile kontesti morë sipas të cilit

pala kërkuese (parashtruesi) ka detyrimin dhe barrën e provës (neni 7 i ligjit mbi procedurën kontesti more dhe nenit 23 i Shtojcës së Ligjit 04/L-033.

- Parashtrues nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që do të mbështeste pretendimin dhe as te ketë arritur te kundërshtoj ndonjë prej argumenteve juridike listuar në vendimin e AL.
- Pala Kundërshtare dëshiron te theksoj këtu se objekt i shqyrtimit para Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në këtë lëndë është shkelja e mundshme ligjore e Autoritetit të Likuidimit e konstatuar kjo në vendimin e ankimuar të këtij autoriteti.
- Duke marrë parasysh (i) natyrën përsëritëse të çështjes, (ii) qartësinë e argumenteve dhe fakteve të përmendura në vendimin e kontestuar , (iv) praktikën e konsoliduar të Gjykatës lidhur më këtë lloj çështje dhe këtë NSH si dhe (vi) shkresat e lëndës në shqyrtim.
- Pala kundërshtare i kërkon Gjykatës të:(i) Refuzojë ankesën dhe (ii) Vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit në zbatim te nenit70.4 të Shtojcës se Ligjit Nr.04/L-033.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3, të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësar apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”,* ndërsa pika 3, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”.*

Sipas nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Kërkesa e ankueses ka të bëjë me njohjen e te drejtës ne pagesat se te ardhurave personale te parealizuar nga Qershori i vitit 1999 e deri ne shtatorin te vitit 2007 ne lartësi prej 20.000,00 Euro si borgjet kryesor me kamata ne lartësi prej 3.5%, duke filluar nga Qershori i vitit 1999 e deri në pagesën përfundimtare, me alternativ qe vendimi i AL te prishet dhe çështja te kthehet ne Rivendosje.

Neni 40 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP parasheh prioritetin e kërkesave dhe interesave që duhet të përmbushen në procedurë të likuidimit, ndërsa pika 1.6.1 e po të njëjtit nen, parasheh pagesën e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto.

Gjykata gjen se kërkesa është e pabazuar për faktin se Shtojca e Ligjit për AKP-në neni 40, paragrafi 1.6.1 i referohet vetëm prioritetit të tri (3) pagave të fundit të papaguara. Prioriteti i lartë megjithatë nuk ia njeh automatikisht të drejtën e punëtorit për tri pagat por i jep prioritet në mesin e borxheve të tri pagave të fundit të cilat mund të kenë mbetur pa u paguar.

E paditura në vendimin e saj **PRN092-0113 datës 09.10.2013**, me të cilën ka refuzuar kërkesën e ankueses në pjesën arsyetuese kur i është referuara nenit 40.1.61 të shtojcës së ligjit të AKP-së nuk ka mohuar se punonjësve u takojnë tre pagat e fundit sipas prioriteteve të cilëve mund ti kenë mbetur të papaguara nga NSH, por ka arsyetuar se *“kërkesa për paga të papaguara duhet të mbështetet në prova që vërtetojnë një detyrim të tillë të ndërmarrjes”*, gjë që ankuesja nuk e ka bërë. Gjykata vëren se ankuesja kërkesën për kompensimin e pagave për të ardhurat personale te parealizuar nga Qershori i vitit 1999 e deri ne shtatorin te vitit 2007 ne lartësi prej 20.000,00 €, nuk e ka mbështetur me asnjë provë para AL prandaj vendimi i AL konsiderohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Ankuesja edhe me ankesë para gjykatës nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se N.SH “Eximkos” i ka mbetur borxh pagat e kërkuara. Kopja e vendimit të atakuar të Autoritetit të Likuidimit, nuk është dëshmi me të cilat dëshmohet e N.Sh i ka mbetur borxh ankueses.

Ankuesja edhe pas dorëzimit të mbrojtjes së AKP-së, përgjigjes se dhënë në raport me mbrojtjen e të paditurës dhe urdhrin të gjykatës të dt. 04 shtator 2023, ka dështuar që të dorëzoj prova me të cilat do të dëshmohej se NSH i ka mbetur borxh paga e pretenduara, andaj Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e saj në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Padiësja ne kërkesë për rishikim te vendimit te AL, ka pasqyrua nj kopje te librezës se punës përmes te secilës pasqyrohet data e lidhjes se mardh enjës se punës nga data 01.09.1989 e deri me dt. 31.08.1990 ne Shkollën Fillore Babush-Ferizaj, më pasë duke vazhduar po ashtu në shkollën fillore “Cernil” nga dt. 01.09.1990 e deri me dt. 31.08.1991, e duke vazhduar ne NSH. “EXIMOS”-Prishtinë nga data 01.03.1995. Paralajmërim për nj ekspertizë gjyqësore për pagat e pa paguara se do ja prezanton gjykatës nuk e ka prezantu. Sipas shkresave aktuale ankuesja nuk ka prezantu as te vetmen nj dëshmi se kurë ju ka ndërprerë

mardhanja e punës sa ka qenë paga mujore për muaj për periudhën sa ka punuar, cila ka qenë pagat e fundit që i ka realizuar nga Nsh “ Eximkos”-Prishtinë. Të gjitha këto dështime të palës ankuese në sigurim provash kanë sjellë bindësh mërin e gjykatës - që ankesa e paraqitur në DHPGJS, ndaj vendimit të sjellë nga AL-AKP-eja si palë kundërshtare,

Në raport me ankesën e ankueses të Refuzohen si të pa bazuar, ndërsa vendimi i AL **Autoritetit të Likuidimit PRN092-0113 datës 09.10.2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligje** të Vërtetohet

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bartë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesja e ka paguar taksën gjyqësore dhe nuk ngarkohet me taksë shtesë.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Dr.sc. Murat Hulaj, Gjyqtar

---